

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tabaku: Paraja e pistë po kontaminon ekonominë shqiptare!
ADRESA	https://albeu.com/lajme/jorida-tabaku-paraja-e-piste-po-kontaminon-ekonomine-shqiptare-sistemi-qe-qeveris-sot-eshte-i-kalbur-dhe-duhet-ndryshuar-eshte-i-ndertuar-per-interesat-e-pakices-varet-nga-lidhjet-me-pushtetit/1005881/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 13:54:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:53:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f75069302dafa3e27e6cee5d47865e42aa834c8df3638197f2a6ed1d3af3c7ae
TEKSTI	80547bc8a450c53fe62068a440b8ebd8572d418dd3f3be68ac8c5e16dc7ffd94a
PAMJA	dd4470478e1259fe40415ec22b1800776059b73846014f67238b25ed751a2d76

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e4143a8d791a8e6eb2eec54e7c3126bd3871c46cd06533236d47cca32a157fa5
E MËPARSHMJA	fe76a0305bf5f484f4bb8fe71b3ce60cc4fbda5723ffd62c8edc73cb90eb5397
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e4143a8d791a8e6eb2eec54e7c3126bd3871c46cd06533236d47cca32a157fa5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [lajme](#)
- [kosovë](#)
- [maqedoni](#)
- [sport](#)
- [showbiz](#)
- [lifestyle](#)
- [tech](#)
- [moti](#)
- [LiveTV](#)

search

- [lajme](#)
- [kosove](#)
- [maqedoni](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [lifestyle](#)
- [shendetesi](#)
- [receta gatimi](#)
- [enciklopedi](#)
- [english](#)
- [sport](#)
- [tech](#)
- [auto](#)
- [livescore](#)
- [REZULTATET ZGJEDHJET 2025](#)
- [moti në shqipëri](#)
- [moti në kosovë](#)
- [moti në maqedoni](#)
- [travel](#)

Tabaku: Paraja e pistë po kontaminon ekonominë shqiptare!

Këtë të enjte, deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, priti në Kuvendin e Shqipërisë 23 përfaqësues të komunitetit të liderëve të rinj të Forumit Ekonomik Botëror (WEF), me të cilët zhvilloi një takim të hapur mbi sfidat dhe perspektivën e zhvillimit të Shqipërisë.

Në takim morën pjesë drejtues kompanish, akademikë, profesionistë të pavarur dhe përfaqësues të fushave të ndryshme.

Diskutimi u përqendrua te rruga e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian, situata ekonomike dhe politike, klima e investimeve dhe ndikimi i teknologjisë në të ardhmen e vendit.

Tabaku theksoi se kritikantët e saj ndaj qeverisjes burojnë nga besimi i Shqipëria dhe potenciali i saj.

"Prej meje nuk do të dëgjoni kurrë fjalë të këqija për Shqipërinë. Unë besoj fort te vendi im dhe te mundësitë që ai ofron. Por sistemi që qeveris sot është i kalbur dhe duhet ndryshuar, në mënyrë që bashkëpunimi me vendet partnere dhe mundësitë që ju përfaqësoni t'u shërbejnë realisht Shqipërisë dhe shqiptarëve", u shpreh ajo.

Sipas Tabakut, Shqipëria ka potencial të madh njerëzor, ekonomik dhe natyror, i cili mbetet i pasfrytëzuar për shkak të një modeli qeverisës që favorizon një pakicë.

"Një qeverisje e ndërtuar për interesat e pakicës nuk mund të ofrojë as kapitalizmin konkurrues dhe as demokracinë funksionale që kërkojnë shqiptarët. Shqipëria ka nevojë për një ekonomi të shumicës, ku mundësitë të mos varen nga lidhjet me pushtetin, por nga puna, aftësia dhe konkurrenca", deklaroi Tabaku.

E pyetur për vizionin ekonomik të opozitës, deputetja e PD-së tha se vendi duhet të shkëputet nga modeli që përqendron pasurinë dhe mundësitë në pak duar.

"Rruga drejt një Shqipërie më të mirë kalon përmes çmontimit të sistemit ekonomik që po mbyt konkurrencën, sipërmarrjen dhe shpërndarjen. Duhet të ndërtojmë një ekonomi që prodhon mirëqenie për shumicën, jo privilegje për një grup të shëmtuar", theksoi ajo.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëbisedimit iu kushtua pastrimit të parave dhe ndikimit të tij në ekonomi. Tabaku paralajmëroi se kapetalet me burim të dyshimtë po deformojnë tregun dhe po largojnë investitorët seriozë.

"Paraja e pistë po kontaminon ekonominë shqiptare. Fakti që kjo çështje tashmë diskutohet gjerësisht edhe jashtë vendit është domethënëse dhe njëkohësisht shqetësues. Ajo deformon konkurrencën, dëmton sektorë të tërë dhe pengon bizneset serioze që të investojnë në Shqipëri", u shpreh Tabaku.

Ajo kritikoi gjithashtu miratimin e ligjeve që, sipas saj, u shërbejnë interesave të veçanta, duke veçuar ligjin për investimet strategjike.

"Ligjet me porosi dëmtojnë njëkohësisht demokracinë dhe të ardhurat e shqiptarëve. Ligji për investimet strategjike është shembulli se si një instrument që duhet të tërhiqte kapital dhe zhvillim u përdor për favore politike dhe ekonomike. Shqipëria ka nevojë për investime të huaja serioze, veçanërisht në teknologji dhe në sektorë të avancuar, jo për projekte që pasurojnë klientët e qeverisë", deklaroi Tabaku.

Duke folur për inteligjencën artificiale, ajo tha se Shqipëria duhet ta shohë teknologjinë si mundësi zhvillimi dhe jo si instrument kontrolli.

"Shqiperia ka potencial ne tushen e inteligjences artificiale, por teknologjia duhet te perdoret per te tuqizuar qytetaret dhe ekonomine, jo per t'i kontrolluar ata. Kur sektoret jetike dhe tradicionalë janë në vështirësi, bëhet shumë më e vështirë të ndërtohet një ekonomi që ecën me ritmin e revolucionit teknologjik", tha ajo.

Në lidhje me politikën e jashtme dhe integrimin europian, Tabaku theksoi se opozita mbështet pa rezerva orientimin euroatlantik të Shqipërisë.

"Objekti ynë kombëtar është Europa dhe anëtarësimi në Bashkimin Europian. Ne kemi entuziazmin dhe gatishmërinë për t'i çuar përpara reformat. Fatkeqësisht, korrupsioni dhe mungesa e vullnetit politik përdoren shpesh nga mazhoranca për të justifikuar vonesat", u shpreh kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

Ajo shtoi se një prej pikave ku opozita ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga qeveria është nisma "Open Balkan", duke ritheksuar se rruga e vetme strategjike për Shqipërinë mbetet integrimi i plotë në Bashkimin Europian.

Përfaqësuesit e Forumit Ekonomik Botëror ndodhen në Shqipëri për një vizitë disaditore, gjatë së cilës po zhvillojnë takime me përfaqësues të të dyja krahëve të politikës. Me herët ata janë takuar edhe me anëtarë të qeverisë dhe të shumicës parlamentare.

Lajme të ngjashme:

Shtuar më 10.09.2026 15:53

 [Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë kërkon dënim me 6 vite burg për Thaçin për pengim të drejtësisë, mbrojtja kërkon lirimin e tij](#)

[Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë kërkon dënim me 6 vite burg për Thaçin për pengim të drejtësisë, mbrojtja kërkon lirimin e tij](#)

 [Sekuestrimi i vilës luksoze të Belinda Ballukut, Klodiana Lala "zbërthen" lidhjen me Arbër Abazin](#)

[Sekuestrimi i vilës luksoze të Belinda Ballukut, Klodiana Lala "zbërthen" lidhjen me Arbër Abazin](#)

 [Lala: Audiopërgjimet e Ahmetajt "bombë" në qeveri, SPAK duhet të hetojë: Yeffet sillej si ministër Mbrojtjeje](#)

[Lala: Audiopërgjimet e Ahmetajt "bombë" në qeveri, SPAK duhet të hetojë: Yeffet sillej si ministër Mbrojtjeje](#)

 [Përplasja për pagat, Lala: Asnjë ekzekutiv nuk mund të anashkalojë GJK-në, gjyqtarët kallëzojnë Petrit Malajn](#)

[Përplasja për pagat, Lala: Asnjë ekzekutiv nuk mund të anashkalojë GJK-në, gjyqtarët kallëzojnë Petrit Malajn](#)

 [Saimir Korreshi përplasjet me Manjën te Komisioni i Ligjeve: Plaka ime nuk di të përdorë as telekomandën, e jo më e-Albania](#)

[Saimir Korreshi përplasjet me Manjën te Komisioni i Ligjeve: Plaka ime nuk di të përdorë as telekomandën, e jo më e-Albania](#)

 [Dosja e SPAK me provat të reja kundër Belinda Ballukut/ Zbardhen mesazhet me biznesmenin Alban Eftimi: "Vilat luksoze" me 2 vaska hidromasazhi si hotel Roccabella në Santorini! Mund të ndihesh e llastuar si në hotel](#)

[Dosja e SPAK me provat të reja kundër Belinda Ballukut/ Zbardhen mesazhet me biznesmenin Alban Eftimi: "Vilat luksoze" me 2 vaska hidromasazhi si hotel Roccabella në Santorini! Mund të ndihesh e llastuar si në hotel](#)

 [Kërkuan takim me Veliajn në paraburgim, SPAK refuzon kërkesën e avokatëve britanikë](#)

[Kërkuan takim me Veliajn në paraburgim, SPAK refuzon kërkesën e avokatëve britanikë](#)

 [Ngërçi me pagat, gjyqtarët kallëzojnë penalisht ministrin e Financave Petrit Malaj](#)

[Ngërçi me pagat, gjyqtarët kallëzojnë penalisht ministrin e Financave Petrit Malaj](#)

Posted in [Kryesore](#), [lajme](#), [shqiperi](#)

të fundit

 [Përplasja në Kuvend dhe akuza për skenar të Beogradit: Gani Qarri zbërthen lëvizjen e fundit të Listës Serbe](#)

[Përplasja në Kuvend dhe akuza për skenar të Beogradit: Gani Qarri zbërthen lëvizjen e fundit të Listës Serbe](#)

 [Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve paralajmëron: Masat do të përshkallëzohen deri në reduktimin dhe kufizimin e veprimtarisë](#)

[Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve paralajmëron: Masat do të përshkallëzohen deri në reduktimin dhe kufizimin e veprimtarisë](#)

 [Adriatik Lapaj rrëfen shoqërimin pas protestës para Kuvendit: Rreth 20 efektivë civilë na morën zvarrë](#)

[Adriatik Lapaj rrëfen shoqërimin pas protestës para Kuvendit: Rreth 20 efektivë civilë na morën zvarrë](#)

 [Publikohen përfituesit e mbi 500 vauçerëve për kondicionerë inverter](#)

[Publikohen përfituesit e mbi 500 vauçerëve për kondicionerë inverter](#)

 [Tabaku: Paraja e pistë po kontaminon ekonominë shqiptare!](#)

[Tabaku: Paraja e pistë po kontaminon ekonominë shqiptare!](#)

 [Deco zbulon detajet e ofertës së Barcelonës për Julian Alvarez dhe qëndrimin e Atletico](#)

[Deco zbulon detajet e ofertës së Barcelonës për Julian Alvarez dhe qëndrimin e Atletico](#)

 [Edon Zhegrova shkëlqen në stërvitjen e Juventusit, kalon Bremerin e Kalulun dhe realizon](#)

[Edon Zhegrova shkëlqen në stërvitjen e Juventusit, kalon Bremerin e Kalulun dhe realizon](#)



[Esim for Global](#) | [Esim for Europe](#) | [Esim for Caribbean](#) | [Esim for USA](#) | [Esim for Italy](#) | [Esim for Spain](#) | [Esim for Turkey](#) | [Esim for Germany](#) | [Esim for Greece](#) | [Esim for Asia](#) | [Esim for World Cup 2026](#) | [Esim for Saudi Arabia](#) | [Esim for Egypt](#) | [Esim for United Arab Emirates](#) | [Esim for Balkans](#) | [Esim for Morocco](#) | [Esim for China](#) | [Esim for United Kingdom](#) | [Esim for Africa](#) | [Esim for Latin America](#) | [Esim for GCC Gulf Cooperation Council](#) | [Esim for Middle East](#) | [Esim for South America](#) | [Esim for Canada](#) | [Esim for Mexico](#) | [Esim for Japan](#) | [Esim for Albania](#) | [Esim for Kosovo](#) | [Esim for Switzerland](#) | [Esim for Tunisia](#) | [Esim for South Africa](#) | [Esim for Algeria](#) | [Esim for Portugal](#) | [Esim for Brazil](#) | [Esim for Argentina](#) | [Esim for Colombia](#) | [Esim for Hong Kong](#) | [Esim for Thailand](#) | [Esim for Macau](#) | [Esim for Malaysia](#) | [Esim for Vietnam](#) | [Esim for South Korea](#) | [Esim for Austria](#) | [Esim for Netherlands](#) | [Esim for Australia](#) | [Esim for Russia](#) | [Esim for India](#) | [Esim for Chile](#) | [Esim for Peru](#) | [Esim for Poland](#) | [Esim for North Macedonia](#) | [Esim for Sweden](#) | [Esim for Finland](#) | [Esim for Norway](#) | [Esim for Belgium](#)
[Albeu.com](#)

© 2003 - 2026 Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...
Search

Kryesore

- [Erion Veliaj](#)
- [Free Esim](#)
- [Zgjedhjet 2025](#)
- [Belinda Balluku](#)
- [SPAK](#)
- [Kombëtarja](#)

Kategori

- [Lifestyle](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Argetim](#)
- [Enciklopedi](#)

Linqet

- [Live tv shqiptare](#)
- [Moti në Shqipëri](#)
- [Travel](#)
- [Horoskopi](#)
- [Livescore](#)
- [News from Albania](#)

Tags

- [Edi Rama](#)
- [Albania News](#)
- [Ilir Meta](#)
- [Piranjat](#)
- [gazeta, tv, portale](#)
- [Sali Berisha](#)

Moti

- [Moti në Tiranë](#)
- [Moti në Prishtinë](#)
- [Moti në Shkup](#)
- [Moti në Durrës](#)
- [Moti në Prizren](#)
- [Moti në Tetovë](#)

© 2003 - 2026 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

- [Kontaktimi](#)
- [Kushtet e Përdorimit](#)
- [Privacy Policy](#)
- [Powered by: orihost.com](#)